




- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News: Morinë – Tentuan të futnin në Shqipëri, lëndë piroteknike dhe mjete prerëse, shoqërohen 12 shtetas Durrës – Finalizohet operacioni policor i koduar “Fazat”

Krujë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Outside”, për goditjen e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve

Divjakë/Finalizohet operacioni policor antidrogë i koduar “Done deal”

Tiranë – Punonjësit e Komisarariatit të Policisë Nr. 1 gjejnë dhe i dorëzojnë një shtetaseje, portofolin që i kishte humbur në rrugë



LajmetOperacionet

12/10/2023

Krujë – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Outside”, Për Goditjen E Veprimtarive Kriminale Në Fushën E Narkotikeve

Krujë

Finalizohet operacioni policor i koduar “Outside”, për goditjen e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve.

Kishin përshtatur një ambient, në fshatin Mafsheq, për tharjen e bimëve narkotike, vihet në pranga 1 shtetas, procedohet penalisht një tjetër. Shpallet në kërkim bashkëpunëtori i tyre.

Sekuestrohen 11 kg lëndë e dyshuar narkotike në proces tharjeje, 1 armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak, që u gjetën të fshehura në afërsi të ambientit ku thareshin bimët narkotike.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Krujë, në vijim të punës për garantimin e rendit dhe sigurisë, evidentimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale, kapjen në flagrancë të shtetasve që kryejnë vepra penale, kontrolleve të ushtruara për parandalimin e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike, bazuar në informacionet e siguruara, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Outside”.

Si rezultat i këtij operacioni u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit A. M., 31 vjeç, banues në Domje, si dhe nisi procedimi në gjendje të lirë për një të mitur 16 vjeç, banues në Fushë Krujë. Gjithashtu u shpall në kërkim shtetasi O. C., 20 vjeç, banues në Fushë Krujë.

Këta 3 shtetas kishin përshtatur një ambient në afërsi të banesës së shtetasit A. M., në fshatin Mafsheq, për tharjen e bimëve narkotike.

Gjatë kontrollit në këtë ambient, shërbimet e Policisë gjetën rreth 11 kg lëndë të dyshuar narkotike kanabis dhe disa bimë në proces tharjeje, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, së bashku me 1 armë zjarri, që u gjet e fshehur gjatë kontrollit të ambientit në afërsi të bimëve narkotike.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme.

angazhimpërkushtimsakrificë👮🚓

tëvendosurkundërkrimit✅

nëçdoskajtëvendit🇦🇱

nëshërbimtëqytetarëve👮🤝👤

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Divjakë/Finalizohet operacioni policor antidrogë i koduar “Done deal”

Durrës – Finalizohet operacioni policor i koduar “Fazat” ▶